

# SHQIPTARËT NË AUSTRI SHËNOJNË 100 VJETORIN E PAVARËSISË ME HATME

Kontribuar nga Administrator  
Mittwoch, 27 Juni 2012  
Azhornuar së fundi Mittwoch, 27 Juni 2012

Bashkësia e shqiptarëve musliman në Wels të Austrisë – xhamia „Mesxhid err-Rresul“, në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptar, 134 vjetorit të „Lidhjes së Prizrenit“ dhe 100 vjetorit të „Ligjit Islam“ në Austri, me datën 23. 06. 2012, organizoi tubimin me titull „Shqiptarët e Welsit në manifestimin e Hatmës së tyre të pestë“.

Në Xhaminë „Mesxhir Err-Rresul“ u organizuar duaja e Hatmës së pestë për nxënësit dhe vijuesit e këtij meketebi, të cilët me atë rast shpalosen një program të pasur dhe të larmishëm me këndim të pjesëve kur’nore, tekbire dhe slavate, recitime dhe ilahi.

Në këtë dua janë përfshirë 14 vijues të mësim-besimit islam, të cilët përfunduan kursin 3 vjeçar të mësimit islam duke përfshirë edhe mësimin dhe përfundimin e leximit të Kur’anit të famshëm.

Mr. Muhidin Ahmeti